Ju keni bërë vaksinën Moderna

Informacion i rëndësishëm për ata që bëjnë vaksinën e COVID-19

Faleminderit që bëtë vaksinën e COVID-19. Ju jeni pjesë e rëndësishme e përpjekjes tonë për të ndalur përhapjen dhe për të ruajtur komunitetet tona.

Nuk jeni ende plotësisht i/e vaksinuar!

Ju duhet të merrni dozën e dytë që të jeni plotësisht të vaksinuar. Deri atëherë, përsëri mund ta merrni dhe përhapni COVID-19. Midis dozave dhe pas dozës së dytë, vazhdoni të praktikoni rregullat për të ulur përhapjen.



Lani duart



Mbani maskë



Ruani distancën



Shmangni grupimet

Jo të gjithë vaksinohen kur vaksinoheni ju. Ndërsa dimë se ajo ul shumë simptomat, ne ende po mësojmë për mbrojtjen e vaksinës kundër COVID-19 në kushtet jetësore.

Regjistrohuni për dozën e dytë të MODERNA

Lini orar ose konfirmoni se si do të merrni dozën e dytë përpara se të largoheni nga vizita e parë.

- **Doza juaj e dytë do të jepet të paktën 28 ditë pasi të keni marrë dozën e parë.**
- **Vaksinohuni në të njëjtin vend si dhe me dozën e parë.**
- **Për dozën e dytë duhet të merrni të njëjtën vaksinë.**

Mund të përjetoni efekte anësore të vogla, efektet anësore të rënda janë të rralla

Efektet anësore të rënda nga vaksinat, përfshi vaksinën e COVID-19, janë të rralla. Efektet anësore më të zakonshme janë të vogla, përfshi:

- **Këputje**
- **Dhimbje**
- **Dhimbje muskujsh/ose e kyçeve**
- **Ethe**
- **Të përziera dhe/ose të vjella**
- **Temperaturë**
- **Dhimbje, lëndim, enjtje dhe skuqje të vendit të injeksionit**

Këto efekte anësore mund të zgjasin disa ditë por nuk janë shkak për alarm. Në se vazhdon dhimbja në vendin e injeksionit ose jeni i/e shqetësuar, kontaktoni mjekun. Në se nuk keni mjek parësor ose doni të raportoni efektet anësore në CDC, vizitoni cdc.gov/vsafe.